FEDERATA ESPORTS KOSOVA

RAPORT

MBI ORGANIZIMIN E KAMPIONATEVE SHTETËRORE SIPAS GRUPMOSHAVE

PËR VITIN 2026

Data	25/08/2026
Periudha	Viti 2026
Institucioni	Federata Esports Kosova – FESK

1. HYRJE

Në kuadër të planit vjetor të punës dhe kalendarit të aktiviteteve të Federatës Esports Kosova (FESK), gjatë vitit 2026 janë planifikuar dhe realizuar aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, me fokus të veçantë në zhvillimin e garave vendore dhe krijimin e mundësive për pjesëmarrjen e sportistëve në kategori të ndryshme të moshave.

Ky raport është hartuar në funksion të dokumentimit të organizimit të kampionateve shtetërore sipas grupmoshave dhe disiplinave, në përputhje me kriteret përkatëse të vlerësimit të aktiviteteve sportive.

2. KALENDARI I AKTIVITETEVE

Kalendari i aktiviteteve të FESK-së për vitin 2026 përfshin kampionate dhe aktivitete të ndryshme, duke përfshirë kategoritë e fëmijëve, juniorëve, studentëve dhe seniorëve.

Nr.	Aktiviteti	Disiplina	Kategoria	Data/Periudha
1	Kampionati i Studentëve	FC 26	Studentë	2026
2	Kampionati Shtetëror	FC 26	Seniorë	31 gusht 2026
3	Kampionati Shtetëror	CS2 Wingman 2v2	Seniorë	11 nëntor 2026 (planifikuar)
4	Kampionati për Junior	CS2	Juniorë	17 maj 2026
5	Pjesëmarrje në Kampionatin Mesdhetar	eFootball / Tekken 8	Përfaqësim ndërkombëtar	24–25 prill 2026

6	Programi i Përzgjedhjes së Talenteve të Rinj	CS2	Fëmijë	Gjatë vitit 2026
7	XP Gaming Festival	CS2, CS2 1v1, FC 26, Rocket League	Kategori të ndryshme	23-24 maj 2026
8	Kampionati Shtetëror	League of Legends	Seniorë	12-13 korrik 2026

3. KAMPIONATET SHTETËRORE TË REALIZUARA

Gjatë vitit 2026 FESK ka realizuar kampionate kombëtare për kategori të ndryshme, ndërsa disa kampionate të tjera janë planifikuar për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2026.

3.1. Kampionati Shtetëror për Juniorë – CS2 2026

Data: 16 maj 2026 | Lokacioni: FESK ESPORTS HUB, Prishtinë | Kategoria: Juniorë

Kampionati Shtetëror për Juniorë në CS2 u organizua me qëllim të zhvillimit të konkurrencës te sportistët e rinj dhe identifikimit të talenteve të reja. Në kampionat morën pjesë rreth 60 lojtarë dhe 11 ekipe. Aktiviteti zgjati rreth 8 orë.

Rezultatet:

Vendi i parë – 6SIDUS: Orgesi, Rioni, Arlindi, Blerti, Dioni

Vendi i dytë – Vushtrria Team: Ylli, Gzimi, Joni, Edoni, Bardhi

Vendi i tretë – Xportal: Auroni, Korabi, Amari, Driloni, Erioni

Aktiviteti u mbështet nga Ujë Rugove dhe Golden Eagle.

3.2. Kampionati Shtetëror – League of Legends 2026

Data: 12 korrik 2026 | Lokacioni: FESK ESPORTS HUB, Prishtinë | Kategoria: Seniorë

Në Kampionatin Shtetëror në League of Legends morën pjesë 16 ekipe. Kampionati shërbeu për zhvillimin e skenës konkurruese vendore dhe krijimin e një sistemi të rregullt të garave.

Rezultatet:

Vendi i parë – Ventira: Nol Hyseni, Altin Sllamniku, Endrit Ademi, Endrit Shabani, Alan Ferko

Vendi i dytë – Xportal

Vendi i tretë – Team 02

4. KAMPIONATET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN E MBETUR TË VITIT 2026

4.1. Kampionati Shtetëror – FC 26

Kampionati Shtetëror në disiplinën FC 26 është planifikuar të mbahet gjatë muajit tetor 2026, përafërsisht në periudhën nga data 10 deri më 22 tetor 2026. Data e saktë dhe lokacioni do të përcaktohen dhe publikohen nga FESK në përputhje me organizimin përfundimtar të garës.

Kategoria: Seniorë | Data e planifikuar: 10–22 tetor 2026 | Statusi: I planifikuar

4.2. Kampionati Shtetëror – CS2 Wingman 2v2

Kampionati Shtetëror në formatin CS2 Wingman 2v2 është planifikuar të zhvillohet më 11 nëntor 2026. Ky aktivitet synon të ofrojë një format konkurrues kombëtar dhe të zgjerojë mundësitë e pjesëmarrjes në disiplinën CS2.

Kategoria: Seniorë | Data e planifikuar: 11 nëntor 2026 | Statusi: I planifikuar

5. AKTIVITETE TË TJERA NË KALENDARI

5.1. Kampionati i Studentëve – FC 26

Aktivitet i dedikuar studentëve, me qëllim të krijimit të mundësive të organizuara konkurruese dhe përfshirjes së komunitetit studentor në aktivitetet e esports-it.

5.2. Pjesëmarrja në Kampionatin Mesdhetar

Në Mediterranean Esports Games 2026, të mbajtur më 24–25 prill 2026 në Bar, Mali i Zi, Kosova u përfaqësua në eFootball nga Genc Shala. Ai zhvilloi 6 ndeshje, regjistroi 3 fitore dhe grumbulloi 9 pikë.

5.3. Programi i Përzgjedhjes së Talenteve të Rinj

Programi synon identifikimin dhe zhvillimin e sportistëve të rinj me potencial për gara kombëtare dhe ndërkombëtare. Kampionati Junior në CS2 i 16 majit 2026 ka shërbyer edhe si platformë për identifikimin e talenteve.

5.4. XP Gaming Festival

Në bashkëpunim me Xportal Esports, FESK ka marrë pjesë në organizimin e XP Gaming Festival, me disiplinat CS2, CS2 1v1, EA Sports FC 26 dhe Rocket League. Në aktivitet morën pjesë mbi 300 sportistë. Në kualifikimet online të CS2 morën pjesë rreth 120 ekipe, ndërsa 8 ekipe u kualifikuan në fazën LAN.

6. PËRMBLEDHJE E KAMPIONATEVE SHTETËRORE DHE STATUSI

Nr.	Kampionati	Grupmosha/Kategoria	Data	Statusi
1	Kampionati Shtetëror Junior – CS2	Juniorë	16.05.2026	Realizuar
2	Kampionati Shtetëror – League of Legends	Seniorë	12.07.2026	Realizuar
3	Kampionati Shtetëror – FC 26	Seniorë	10–22.10.2026	Planifikuar
4	Kampionati Shtetëror – CS2 Wingman 2v2	Seniorë	11.11.2026	Planifikuar
5	Kampionati për Juniorë	Juniorë	17 maj 2026	Realizuar

7. DOKUMENTACIONI DHE DËSHMITË MBËSHTETËSE

- Kalendari vjetor i aktiviteteve i aprovuar nga organet kompetente të FESK-së;
- Vendimet për organizimin e kampionateve shtetërore;
- Procesverbalet e takimeve dhe vendimeve për organizimin e aktiviteteve;
- Raportet e kampionateve të realizuara;

- Listat e pjesëmarrësve dhe ekipeve;
- Rezultatet përfundimtare të garave;
- Materialet fotografike dhe dëshmitë e publikimit të aktiviteteve;
- Raportet përfundimtare për kampionatet e planifikuara pasi të realizohen.

8. PËRFUNDIM

Federata Esports Kosova gjatë vitit 2026 ka zhvilluar dhe planifikuar një program të strukturuar të kampionateve dhe aktiviteteve, duke përfshirë kategori të ndryshme të sportistëve. Krahas kampionateve të realizuara për juniorë dhe seniorë, FESK ka planifikuar edhe Kampionatin Shtetëror në FC 26, Kampionatin Shtetëror në CS2 Wingman 2v2 dhe Kampionatin për Fëmijë.

Realizimi i këtyre aktiviteteve synon zhvillimin e konkurrencës vendore, rritjen e pjesëmarrjes së sportistëve në kategori të ndryshme, identifikimin e talenteve të rinj dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të kampionateve kombëtare në esports.

9. PUBLIKIMI DHE TRANSPARENCA

Data e miratimit të raportit	25.08.2026
Data e publikimit	28.08.2026
Platforma	Faqja zyrtare e Federatës Esports Kosova